

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË



## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

28.04.2020

Për: BOE: "Boshnjaku-B" shpk, me nr. Nipti K72627402H dhe "Bajrami-N" shpk, me nr. Nipti K02727202O dhe "Mateo", shpk me nr. Nipti L26310801C dhe "Pese Vellezerit", me nr. Nipti L22925402C, adresa: Fier.

Procedura e prokurimit: **E hapur (pune)**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-49311-02-05-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "*Rikonstruksion i Rrugeve te Lagjes siper Stacionit te Trenit, ne Qytetin e Rrogozhines, faza e pare*".

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Buletini i Njoftimeve Publike, Date 10.02.2020, Nr.5**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimimë i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e shoqerise, **BOE: "Boshnjaku-B" & "Bajrami – N" shpk & "METEO" shpk & "Pese Vellezerit" shpk,**

**"Boshnjaku-B" shpk, me nr. Nipti K72627402H dhe "Bajrami-N" shpk, me nr. Nipti K02727202O dhe "Mateo", shpk me nr. Nipti L26310801C dhe "Pese Vellezerit", me nr. Nipti L22925402C**, me vlerë te ofruar : **91.568.615** (nentedhjete e një milion e peseqind e gjashte dhjete e tete mijë e gjashtëqind e pesembedhjete) leke pa tvsh.

2. Oferta e shoqerise **BOE: "Biba-X" shpk & "Gjikuria Construction" shpk, " Biba-X" shpk**, me numer Nipti: **K326188815N** dhe **"Gjikuria Construction" shpk**, me nr. Nipti J62903456H, me vlerë te ofruar : **55.000.020** (pese dhjete e pese milion e njezet ) leke pa tvsh.

3. Oferta e shoqerise, **"Elda-VL", shpk** me nr. Nipti: **K67106202W** me vlerë te ofruar : **0** (zero) leke pa tvsh, skualifikohet nga kvo-ja, sepse nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe dokumentacion ligjor.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Ka ofertues te skualifikuar.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**Dy nga shoqerite e tjera pjesmarrese ne tender, 1. BOE: "Biba-X" shpk & "Gjikuria Construction" shpk**

**2." ELDA –VL" shpk, u** skualifikuan nga KVO-ja, per arsyet e meposhtme:

Oferta e shoqerise **BOE: "Biba-X" shpk & "Gjikuria Construction" shpk, " Biba-X" shpk**, me numer Nipti: **K326188815N** dhe **"Gjikuria Construction" shpk**, me nr. Nipti J62903456H, me vlerë te ofruar : **55.000.020** (pese dhjete e pese milion e njezet ) leke pa tvsh, eshte refuzuar nga KVO-ja, per arsyet se:

**Kriteret e per gjithshme te kualifikimit**

1.Operatoreve ekonomike nuk kane paraqitur marreveshje te noterizuar per krijimin e bashkimit te operatoreve ekonomike.

2.Operatoret ekonomik nuk kane paraqitur as prokure te posacme te noterizuar ne funksion te bashkimit te operatoreve ekonomike.

Konkluzioni eshte se operatoret ekonomik nuk plotesojne kriteret e per gjithshme te kualifikimit ne kundershtim me nenin 44 pika 2 dhe 46 pika C te Ligjit te Prokurimeve Publike si dhe nenit 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" dhe per pasoje nuk zoterojne personalitet juridik per tu paraqitur si bashkim operatoresh ekonomik ne kete procedure prokurimi

3.Operatori ekonomik Gjikuria figuron debitore ndaj organeve tatumore ne lidhje me pagimin e tatimeve dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore , fakt i cili provohet me vertetimet nr.T01853931 date 21.2.2020 dhe vertetimit nr.T 01925649 date 13.3.2020 ne Shumen 3. 587 .174 leke te leshuar nga Drejtoria e Sherbimit te Tatimpaguesve te Medhenj dhe te paraqitura nga vete operatori ekonomik "Gjikuria" shpk ne sistemin e prokurimeve elektronike .

Per te verifikuar kete fakt ne baze te deklarimit te operatorit ekonomik "Gjikuria" shpk ,Komisioni i Vleresimit te Ofertave verifikoj nepermjet portalit unik elektronik qeveritare E-Albania situaten tatumore te ketij subjekti.Mbas verifikimit sic vertetohet me vertetimin e leshuar me ane te sistemit elektronik qeveritar E-Albania te dates 17.3.2020 me nr.T01930490 rezultoi se ky operator ekonomik ka detyrime te papaguara.

Nisur nga sa pershkruam me siper konkludojme se operatoret ekonomik te mesiperm nuk plotesojne kriteret e per gjithshme te kualifikimit.

#### ***Kriteret e vecanta te kualifikimit***

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur per permbushjen e kritereve te posacme te kualifikimit jane konstatuar mangesite e me poshtme :

1.Operatori ekonomik Gjikuria nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksvae vendore per ushtrimin e aktivitetit ne Bashkine Puke per vitin 2017 fakt i cili vjen ne kundershtim me piken 2.1.1 te kritereve te vecanta te kualifikimit.Nga te dhenat ne ekstraktin historik ne Qendren Kombetare te Biznesit rezulton se operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet per periudhen 27.05.2016 – 05.10.2017 ne adresen "Shkoder, Puke , Perroi Gomsiqes ne Hec Vau dejes" dhe duke nisur nga ky fakt ka qene i detyruar te paraqese vertetim per shlyerjen e taksave vendore nga Bashkia Puke.Mosparaqitja e ketij dokumenti shkakton drejtperdrejt mosperm bushje te kritereve te vecanta te kualifikimit.

2.Operatori ekonomik Biba X nuk disponon piken N.P. -6 A te licences se zbatimit te punimeve ne ndertim fakt i cili vjen ne kundershtim me piken 3.3.2. te kritereve te vecanta te kualifikimit ,kapaciteti teknik .

Ne preventivin e punimeve ky operatore ekonomik ka marre persiper kryerjen e punimeve per te cilat nuk ka licence zbatimi sic jane kryerja e punimeve te kategorise Np – 6 "Diga dhe tunele hidroteknike ", punime te per te cilat nuk disponon licence zbatimi punimesh.

3.Eshte konstatuar se operatoret ekonomik nuk disponojne makineri buqesore me goma me zogolature 60/80

sic eshte kerkuar ne piken 48 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve.

Fatura tatimore e shitjes me nr.86277697 serie date 29.12.2014 pershkruan qe objekti i shitjes eshte makineri per shitje pemesh dhe hidrombjellje cope 1 . Kjo fature tatimore shitje nuk eshte shoqeruar me deklarate doganore importi makinerie per te provuar origjinen e tij apo ndonje dokument identifikimi te mjetit dhe as foto te makinerise dhe per me teper nuk ka asnje lloj specifikimi qe eshte makineri per shkuljen e pemeve eshte me goma dhe me zogolature 60/80 .

4.Operatori ekonomik Biba- X, nuk ka paraqitur dokument pronesie mbi fabriken e asfaltit por ka paraqitur nje akt-shitje shkresore dhe jo te noterizuar ,document qe nuk ka asnje vlere juridike per nje tjetersim te nje pasurie te paluajsthe fakt i cili vjen ne kundershtim me piken 78 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve

5.Operatori ekonomik Gjikuria, nuk ka paraqitur mjete Kamion me tonazh 7.5 deri me 18 ton, sasia 5 cope ne kundershtim me piken 2 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve.Mjetet me targa AA691 GM ,AA692GM ,AA873 DN , AA937HH dhe AA589HH te marra me qera ne baze te kontrates me nr.1251 Rep dhe nr.244 Kol qe jane paqitur ne deklaratene per disponueshmerine e mjeteve si mjete me tonazh 7.5 deri 18 ton , jane me tonazh mbi 18 ton fakt i vili provohet nga dokumentet e mjetit te paraqitura si leje qarkullimi dhe certificate e kontrollit teknik .

6.Mjeti me targa AA673 EM i paraqitur ne deklaratene per disponueshmerise se mejeteve nga ana e operatorit ekonomik si kamioncine me tonazh deri ne 3.5 ton , eshte i tonazhit 3.5 deri me 3 7.5 ton, fakt i cili bie ne kundershtim me kerkesat e pikes 4 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve.

7.Mjeti me targa AA 364 JD i paraqitur si kamion me tonazh 3.5 deri ne 7.5 ton nga ana e operatorit ekonomik Gjikuria eshte i tonazhit 7.5 deri 18 ton fakt i cili bie ne kundershtim me piken 3 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve ne DST.

-8.Mjeti me targa AA 284 N D i paraqitur si kamion me tonazh 3.5 deri ne 7.5 ton nga ana e operatorit ekonomik Gjikuria eshte i tonazhit 7.5 deri 18 ton fat i cili bie ne kundershti me piken 3 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve ne DST.

-9.Mjeti me targa AA 215 HR i paraqitur si kamion me vinc me tonazh 7.5 deri ne 18 ton nga ana e operatorit ekonomik Gjikuria eshte i tonazhit mbi 18 ton fakt i cili bie ne kundershti me piken 5 te deklarates se disponueshmerise se mjeteve ne DST.

10.Operatoret ekonomik Biba X dhe Gjikuria nuk kane paraqitur makineri hidrombjellje cope 2 .Makineria hidrombjellje e marre me nenqira me kontraten nr.1250 Rep dhe nr.243 Kol nga operatori ekonomik Agro-Korani i cili nga ana tjeter e ka marre me qira nje operatori ekonomik te huaj (Italian) qe nuk ushtron aktivitet ne territorin shqiptare , nuk merret parasysh pasi per kete makineri nuk eshte paraqitur asnjë dokument doganore qe verteton hyrjen e saj ne territorin shqiptare dhe per pasoje pasjen e mundesise fizike per ta dhene me qera mjetin , ne menyre qe te jete i disponueshem per permbushjen e kontrates .Ky fakt perben mospermbose te kriterive te vecanta te kualifikimit.

11.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur numrin e kerkuar te mjeteve te llojit "Autovinc me kosh mbi 9-meter"

qe eshte 2 cope sipas Shtojces se mjeteve te kerkuara , fakt i cili perben mosperm bushje te kritereve te vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik.

12.Operatori ekonomik Biba-X dhe Gjikuria nuk ka paraqitur numrin e kerkuar te pajisjeve te llojit betoniere pasi ai ka paraqitur 10 cope nga 11 cope qe eshte numri i kerkuar .Betonieria e pretenduar me faturen me nr.serie 86277673 dhe nr.fature 53 date 08.0.12013 figuron me bleres personin juridik “Ajdini Inerte” dhe jo operatorin ekonomik Biba-X sic eshte deklaruar ne deklaratene disponueshmerise se mjeteve .

13.Operatoret ekonomik Biba-X dhe Gjikuria nuk zoterojne “Drejtues teknik” te punesuar prane tyre qe te jete certifikuar per ushtrimin e profesionit te ekspertit privat zjarrfikes fakt I cili vjen ne kundershtim me kerkesat e vecanta per kualifikim .

#### Cmimi Ofertes

Nisur nga fakti se ne procedure e prokurimit objekt vleresimi jane vetem dy oferta te vlefshme dhe se oferta e paraqitur ne vleren 55 000 020 leke pa tvsh eshte 25 % me ulet se fondi limit i perllogaritur ne vleren 91 666 666 leke pa tvsh , komisioni i vleresimit te ofertave vendos te procedoi me kerkesen per argumentim dhe sqarime per oferten anomalisht duke ja paraqitur operatoreve ekonomik Biba X dhe Gjikuria .

Me shkresen e dates 23.3.2020 me titull “Kthim pergiigje” operatori ekonomik “Biba-X” brenda afatit ligjore ka paraqiture shpjegimet e tij ne lidhje me oferten anomalisht te ulet .Komisioni i Vleresimit te Ofertave pasi analizoi ne teresi argumentimet e paraqitura nga operatori ekonomik ‘Biba –X’ ne lidhje me oferten anomalisht te ulet vendosi te mos e pranoje ate dhe te deklaroje perfundimisht oferten e paraqitur anomalisht te ulet ne zbatim te nenit 66 pika 5 te vkm nr.914 date 29.12.2014 ‘Per miratimin e rregullave te prokurimit public” per arsyet qe po paraqesim me poshte :

Nga analizimi ne teresi i shpjegimeve te operatori ekonomik “Biba-X” konstatohet qe keto shpjegime nuk trajtojne ne asnjje moment ne menyre te detajuar elementet e ofertes pasi ne asnjje rast nuk shpjegojhet :

a) Ana ekonomike e metodes se ndertimit ,procesi i prodhimit dhe sherbimet e ofruara .

b)Zgjidhjet teknike te ofruara ,kushtet favorizuese ne lidhje me kryerjen e punimeve

c)Zbatueshermeria e detyrimeve ,qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes ne vendin e punes ku do te kryhet puna ,sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi.

Shpjegimet e operatorit ekonomik bazohen vetem ne faktin e pronesise se nje pjese se impianteve te prodhimit ,mjeteve dhe pajisjeve te kerkuara dhe distances me kantierin e ndertimit.Ne asnjje moment operatori ekonomik nuk ka paraqitur ne menyre te detajuar kostot e prodhimit te materialit qe do te perdoret per te realizuar vepren si dhe koston e ndertimit .Argumenti i operatorit ekonomik se ndodhet ne nje distance te afert selia e tij me kantierin e ndertimit ku do te realizohet vepra nuk perben shkak per te justifikuar vleren anomalisht te ulet .

Duke analizuar dhe analizen teknike te cmimeve qe i eshte bashkangjitur shkreses per shpjegime te ofertes anomalisht te ulet te paraqitur nga operatori ,konstatohet se ajo eshte e hartuar jo ne perputhje me kerkesat e preventivit te punimeve per zerat e meposhtme :

1.Zeri shkulje peme ulliri dhe mbjellje me makineri me zinxhire me buke dheu 40/60 nuk eshte parashikuar kosto e makinerise ne cmim .

2.Cmimi i cimentos i dekluar nga ana e operatorit ekonomik ne zera te ndryshem ne analizen teknike te cmimeve ka diferenca cmimi nga 57 leke per kg ne pese 5.7 leke per kg fakt I cili e ben teresisht joti e bazuar oferten e cmimeve .Theksojme faktin se cimentoja eshte nje material qe nuk prodhohet nga operatori por blihet ne treg dhe ku cmimi minimal me shumice ne treg eshte 8.1 leke per kg.

3.Ne analizen cmimeve zeri shtresa betoni per pusete b/a C12:15 shiu 40/60,h=100 cm ,me kapak gize eshte paarshikuar cmimi 4500 leke ,kurse ne preventiv i njejt ze eshte ofertuar 5800 leke .

4.Per zerat e punimeve me poshtem operatori ekonomik nuk ka llogaritur ne analizen teknike te cmimit koston e transportit.

1.Trotuar me 6 cm beton me pllaka ,

2.Tombino me tuba betoni Ø1000 mbi shtrese betoni ,

3.F.V. shtylla metalike per ndricim H=7m d=160mm ,

4.F.V. shtylla metalike KRH-MSI 1500:1500:10 ,

5.Ndricues Led 94w ,

Operatori ekonomik nuk ka llogaritur ne analizen teknike te cmimit koston e transportit.

5.Ne analizen teknike te cmimeve te materialit “Bitum” tek zeri shtrese binderi me makineri 6 cm deklarohet 50 leke kg ndersa tek zeri shtrese asfaltobetoni me makineri 4 cm deklarohet 55 leke per kg duke treguar se nuk eshte llogaritur sakte.

6.Zerat mbushje me cakull ,material cakull gurore ne nje rast deklarohet 820 leke per m<sup>3</sup> ndersa ne nje rast tjeter deklarohet 870 leke .

Te gjitha keto pasaktesi dhe mosperfshirje te zerave te punimeve ne analizen teknike te cmimeve si dhe mosperputhjet e preventivit te punimeve me analizen teknike te cmimeve cojne ne konkluzionin se shpjegimet e operatorit ekonomik jane te pabaza dhe jo te llogaritura teknikisht ne perputhje me ligjin .

Per sa parashtruan me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave vendosi ta shpallo anomalisht te ulet oferten e operatoreve ekonomik “Biba-X” shpk dhe “Gjikuria” shpk dhe ta refuzoje ate.

Oferta e shoqerise, “**Elda-VL**”, shpk me nr. Nipti: **K67106202W** me vlore te ofruar : **0** (zero) leke pa tvsh, skualifikohet nga kvo-ja, sepse nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe dokumentacion ligjor.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendor, informojmë:: BOE: “**Boshnjaku-B**” shpk, me nr. Nipti

**K72627402H & "Bajrami-N" shpk, me nr.Nipti K027272020 & "Mateo", shpk me nr.Nipti:L26310801C & "Pese Vellezerit", me nr. Nipti L22925402C, adresa:** Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **91.568.615** (nentehjete e një milion e peseqind e gjashtë dhjete e tete mijë e gjashtëqind e pesembedhjete)leke pa tvsh, është identifikuar si oferta suksesshme.Rrjedhimisht, jeni i latur të paraqisni pranë **Adresa: Bashkia Rrogozhine, Lagjia nr.1 Rruga Kavajes** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit,Brenda **30 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqi nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë,**25.03.2020**

Ankesa: ka ose jo, **ka patur ankesa**

(nëse ka), ka marrë përgjigje në date, 01-04-2020, Nr.1948/1 Prot, **gjithashtu ka dhe një Vendim Nr.146/2020, date 23.04.2020, te Komisionit te Prokurimit Publik, per lejimin e vazhdimit te metejshem te procedures se prokurimit ne fjale, nga Autoriteti Kontraktor.**

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Antonela DEDEJ**